

Përmbledhje e politikave të drogave


Një histori e shkurtër e përceptimit global ndaj drogave

Përdorimi i substancave psikoaktive është po aq i vjetër sa edhe egziston dokumentimi i shkruar. Publikime shkencore raportojnë se përdorim të substancave psiko-aktive ka pasur që rreth 5000 vite më parë. Kësisoj, kjo e bën këtë dukuri shumë komplekse dhe me ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e historisë së njeriut. Mirëpo edhe pse përdorimi i substancave psikoaktive ka qenë prezent në çdo kulturë përgjatë historisë së njerëzimit për qëllime të ndryshme, sikurse ato mjekësore, rekreative e deri tek përdorimi i këtyre substancave për arsyë religjioze apo spiritual, sot drogat dhe përdorimi i tyre në shumë vende të botës shikohen më shumë nga pikëpamja e penalizimit dhe vizioni i "luftimit të drogave" dhe se sa nga pikëpamja e politikave të drogave me çasje të shëndetit publik dhe të të drejtave të njeriut.

Termi "Lufta kundër drogave" (përfshirë këtu edhe përdorimin e drogave), së pari ishte përdorur nga presidenti i SHBA-ve Rixhard Nikson në vitin 1971, si

reagim kundër disa trendeve tek të rinjtë amerikanë. Gjatë kohës kur Niksoni ishte president, droga ishte bërë simbol i rrebelimit, trazirave sociale dhe mospajtimeve politike, sikurse ishte edhe lufta në Vietnam.

Kjo do të nënkuptonte një prioritet pa-precedent për t'i luftuar në çdo formë kontrabanduesit dhe kultivuesit e drogave, por edhe luftimin e çdo forme të asociimit me drogën, përfshirë këtu edhe përdoruesit e drogave apo personat me posedim të vogël të çfarëdo lloji të substancave ilegale. Dekadat në vijim u dominuan kryesisht me konventa të OKB-së dhe krijime të institucioneve dhe agjencive për t'i përndjekur kultivuesit, për t'i kontrolluar substancat dhe për t'i kriminalizuar përdoruesit e drogave, në të cilat dallimi mes përdoruesëve dhe kontrabanduesëve nuk theksohet aspak. Kësisoj, përceptimi diskriminues dhe stigmatizues global ndaj substancave psikoaktive dhe përdoruesëve të tyre është krijuar kryesisht në 100 vitet e fundit të politik-bërjes.



Politika alternative ndaj kontrollit të drogave

Edhe pse shtetet si Spanja dhe Italia nuk penalizojnë me vepër penale përdoruesit me posedim personal të drogës që nga vitet 1980-ta, rasti i strategjisë së dekriminalizimit të drogave në Portugali në vitin 2001 njihet më së shumti në fushën e politikave të drogës për faktin se është strategjia më gjithëpërfshirëse. Bazuar në këtë strategji, asetet policore fokusohen më shumë në trafikantët dhe transportuesit e drogave, përderisa fondet tjera alokohen për trajtim të përdoruesëve, praktika të zvogëlimit të dëmit dhe ekipeve të terrenit.

Disa nga të gjeturat e studimit të vitit 2012 në Portugali si pasojë e kësaj strategjie kanë raportuar se:

- Portugalia ka pësuar rritje të kërkesës për trajtim nga përdoruesit e drogave (afërsisht 60% rritje në vitin 2012).
- Në ndërkohë, shkalla e vdekjeve të shkaktuara nga drogat ka rënë pesë herë më poshtë se mesatarja e BE-së.
- Numri i vdekjeve të lidhura me drogën është zvogëluar nga 131 në 2001 në 20 në 2008.
- Përdorimi i drogës në mesin e adoleshentëve (13-15 vjeç) dhe përdoruesëve "problematik" është zvogëluar.

Shtete të tjera që i kanë dekriminalizuar të gjitha drogat:

Slovenia, Kroacia, Holanda, Latvia, Qekia, Armenia.

Shtete që e kanë dekriminalizuar kanabisin:
Zvicra, Gjermania, Belgjika, Israeli.

Rasti studimor në Kosovë

Në bazë të raportimeve e pretendimeve të ndryshme verbale për shkelje të të drejtave të njeriut, diskriminim dhe stigmatizim të vazhdueshëm të përdoruesëve të drogave dhe pacientëve në OJQ Labyrinth, është

përpiluar një studim rasti¹ i raportimeve të shkeljeve të të drejtave të njeriut tek klientët e OJQ Labyrinth. Ky studim u realizua në kuadër të projektit për mbojten e të drejtave të njeriut tek përdoruesit e drogave. Në vijim janë shkëputur disa fragmente të këtij raporti:

“Pretendimet e të intervistuarit në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nga zyrtarët policor gjatë dy përvojave të ndalimit policor, e ngrisin dyshimin se zyrtarët policor zbatojnë praktika që mund të cilësohen si torturë apo trajtim çnjerëzor, mizor ose poshtërues ndaj personave të arrestuar për shkak të dyshimit se kanë kryer vepra penale që ndërlidhen me substanca narkotike”

“Përveç kësaj, pretendimet e personave të intervistuar në lidhje me praktikën e ndryshme të trajtimit të pabarabartë nga institucionet shëndetësore janë shumë shqetësuese sidomos duke pasqyruar gjendjen e ndjeshme dhe nevojën për trajtim mjekësor të personave që janë përdorues të drogave.”

Rekomandime:

1. Në bazë të të gjeturave të raportit të mësipërm dhe punës së vazhdueshme me përdorues të drogave, janë përpiluar rekomandimet në vijim:
2. Të krijohet një komision multidiciplinar, përfshirë këtu edhe përdoruesit, i cili do të synonte zhvillimin e politikave që do të shërbenin në kontekstin e Kosovës dhe për nevoja të përdoruesve.
3. Politikën të bëhen asisoj që përdoruesit mos të stigmatizohen, kriminalizohen dhe mos të ngurrojnë apo të kenë frikë të kërkojnë ndihmë për trajtim.
4. Të mbështeten praktikën e zvogëlimit të dëmit.
5. Të debatohet rreth mundësive të ndryshme të dekriminalizimit, ku sasitë e vogla për posedim personal të mos ndëshkohen me vepra penale, por me gjobë, vërejtje të parë apo me trajtim të obligueshëm. Gjithashtu, përdoruesit mos të konsiderohen kriminelë por persona në nevojë të shërbimeve adekuate (ndërlidhet me rekomandimin numër 2).
6. Politikën e drogës të kenë më shumë çasjen e shëndetit publik se sa atë policorë dhe ndëshkues.

1) Studimin në fjalë mund ta gjeni në web-faqen e OJQ Labyrinth apo me kërkesë në zyrat e kësaj OJQ-je.

* **Dekriminalizimi** nënkupton marrjen e një akti ligjor që është ilegal dhe e heq dënimin penal; për shembull, ju nuk merrni një dosje penale kur vozitni shpejtë me veturë, edhe pse ju ende duhet të paguani gjobën.

Legalizimi nënkupton marrjen e një akti që është ilegal dhe e bën atë të ligjshëm, pa gjoba, ndëshkime, etj.